

L I G J
Nr.8181, datë 23.12.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 473 ndryshohet si vijon:

Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës së shkalës së parë, të Gjykatës së Apelit dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, për shkaqet e parashikuara në nenin 472, Prokurori i Përgjithshëm mund të ushtrojë rekurs për prishjen e vendimit në interes të ligjit.

Rekursi kundër vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, shqyrtohet nga kolegjet e bashkuara të kësaj Gjykate.

Për kalimin në seancë gjyqësore të rekursit ndaj vendimeve të formës së prerë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, duhet të vendoset në dhomën e këshillimit. Anëtarët e kësaj gjykate që kanë dhënë vendimin ndaj të cilit bëhet rekurs nuk kanë të drejtë të bëjnë pjesë në dhomën e këshillimit.

Për shqyrtimin e rekursit, zbatohen rregullat e gjykimit në kolegji.

Rekursi në interes të ligjit ushtrohet brenda një viti nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1697, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha